

U D H Ë Z I M
Nr.1, datë 6.6.1994

**PËR PROCEDURËN E HAPJES DHE PËRDORIMIT TË LLOGARIVE PRANË BANKËS SË
KURSIMEVE PËR DHËNIEN E KOMPENSIMIT PASUROR ISH TË PËRNDJEKURVE
DHE TË DËNUARVE POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.184, datë 4.5.1994 “Për dhënie e kompensimit pasuror ish-të përndjekurve dhe të dënuarve politikë nga sistemi komunist”, me propozimin e Komitetit të Ish-të Përndjekurve Politikë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Kursimeve, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

I. PËR KOMPENSIMIN ME PARA NË DORË

A. KOMITETI I ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

1. Përcakton shumën e kompensimit me para në dorë për çdo përfitues, në zbatim të kompetencave që i njihen sipas dispozitave ligjore.

2. Duke respektuar kufijtë e parashikuar në planin e buxhetit të shtetit për këtë shpenzim, nëpërmjet thesarit të shtetit, kalon shumat për t’u paguar për periudhën përkatëse, të miratuara nga thesari i shtetit.

3. Përpilon urdhrin me shkrim (për çdo përfitues ose në formë liste) për Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Kursimeve për t’u paguar përfituesve shumat përkatëse, duke specifikuar, veç të tjerave, edhe adresën dhe degën e Bankës së Kursimeve ku do të bëhet pagesa.

4. Njofton përfituesin dhe personat e tjerë të interesuar për t’u paraqitur në degën e Bankës së Kursimeve në rrethin përkatës.

5. Mbi bazën e konfirmave bankare të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Kursimeve, bën regjistrimin dhe azhurnimin e pagesave të kryera.

B. BANKA E KURSIMEVE

1. Mban llogari të posaçme në emër të Komitetit të Ish-të Përndjekurve Politikë, në të cilën përqendrohen të gjitha pagesat për të përndjekurit politikë.

2. Bën shpërndarjen për degët e Bankës së Kursimeve në rrethe në përputhje me urdhrat (listat) e Komitetit të Ish-të Përndjekurve Politikë.

3. Degët e Bankës së Kursimeve i evidencojnë veprimet në një llogari të përkohshme të emërtuar “Pagesa për t’u kryer ish-të përndjekurve politikë” dhe njoftojnë të interesuarit në adresën përkatëse. Llogaria “Pagesa për t’u kryer ish-të përndjekurve politikë” është llogari e pafrytshme.

4. Pagesa u bëhet përfituesve të drejtpërdrejtë, pasi vërtetohet identiteti i tyre në bazë të dokumenteve ligjore (letërnjoftimi, certifikatë etj.), duke u kërkuar edhe një fotokopje të dëshmisë përkatëse.

5. Kur për arsye të ndryshme nuk paraqitet përfituesi i drejtpërdrejtë, por trashëgimtarët e tij, zbatohen dispozitat e Kodit Civil për trashëgiminë, të vërtetuara me prokurë. Në këto raste dega e bankës mban në dokumentet e saj një kopje të dokumentit justifikues (prokurë, akt trashëgimie etj.).

6. Përfituesit përkatës sipas pikave 4 dhe 5 të mësipërme kanë të drejtë të tërheqin menjëherë shumën e parave, t’i depozitojnë ato në Bankën e Kursimeve ose në ndonjë bankë tjetër, si dhe të anulojnë çdo pagesë tjetër që zbatohet nga sistemi bankar në Shqipëri.

7. Degët e Bankës së Kursimeve njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme për pagesat e paekzekutuara, brenda 3 muajve nga data e urdhëruar, si dhe për çdo problem të mundshëm në marrëdhëniet me përfituesit e drejtpërdrejtë ose indirekt. Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Kursimeve informon Komitetin e Ish-të Përndjekurve Politikë për të marrë masat e nevojshme për sistemimin e gjendjes.

II. PËR ÇELJEN E LLOGARIVE PËR PRIVATIZIMIN

Shuma e lekëve të privatizimit që shteti shpërndan për ish-të përndjekurit politikë, përbën një hua shtetërore. Afati i shlyerjes së kësaj huaje do të jetë në varësi nga privatizimi. Ajo pjesë e huasë që nuk do të shlyhet nëpërmjet këtij procesi, do të shlyhet nga shteti në forma të tjera, sipas akteve dhe mënyrave që do të përcaktohen nga shteti.

A. KOMITETI I ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

1. Përcakton shumën e kompensimit me xhirim në llogari për çdo përfitues, në zbatim të kompetencave që i njihen sipas dispozitave ligjore dhe urdhëron me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Kursimeve për të kryer veprimet përkatëse.

2. Njofton përfituesin ose persona të tjerë për t'u paraqitur në degën e bankës në rrethin përkatës.

3. Koordinon punën me Agjencinë Kombëtare të Privatizimit për nxitjen e procesit të privatizimit nëpërmjet përdorimit të parave-llogari.

4. Evidencën veprimet e kryera nga Banka e Kursimeve dhe ndjek në vijimësi situatën.

5. I delegon detyra të caktuara degëve të Komitetit të-Ish të Përndjekurve Politikë në rrethe për kryerjen me efektivitet të detyrave të mësipërme.

6. Në fund të çdo periudhe 4-mujore Komiteti i Ish-të Përndjekurve Politikë raporton në Drejtorinë e Buxhetit dhe në Drejtorinë e Thesarit pranë Ministrisë së Financave shumën në lekë privatizimi që ka akorduar.

B. BANKA E KURSIMEVE

1. Çel llogari jashtë bilancit në emër të Komitetit të Ish-të Përndjekurve Politikë, në të cilën evidencohen shumat që u jepen përfituesve përkatës.

2. Çel llogari jashtë bilancit në emër të llogarisë së thesarit pranë Bankës Kombëtare Tregtare në rrethe, në të cilën evidencohen shumat që paguhën për privatizimin e objekteve nëpërmjet parave-llogari.

3. Çel kartelë për çdo përfitues, të cilin e pajis me librezë të veçantë "Llogari në letra me vlerë për privatizim", pasi sigurohet për identitetin e përfituesve të drejtpërdrejtë ose trashëgimtarët e tyre, në zbatim të dispozitave të Kodit Civil, duke kërkuar një fotokopje të dokumenteve përkatëse (dëshmi të statusit, akt trashëgimie etj.).

4. Zbaton urdhrin me shkrim të përfituesve, duke azhornuar edhe librezën për:

a) xhirimin e shumave në drejtim të llogarisë së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në degët e Bankës Kombëtare Tregtare brenda të njëjtit rreth, si dhe në rrethe e bashki të tjera, në emrin e vet ose të kujtdo tjetër që ka fituar të drejtën e privatizimit të një objekti të caktuar;

b) për kalimin pjesor ose tërësor të letrave me vlerë te një person tjetër, duke e pajisur atë me librezën përkatëse, pavarësisht nëse është i përsekutuar ose jo, nëpërmjet shitjes së shumave a dhurimit të tyre për t'u përdorur në procesin e privatizimit.

5. Për punën që kryen Banka e Kursimeve, komisionet bankare i ngarkohen përfituesit.

6. Për mbajtjen e llogarive dhe procedurat kontabël të Bankës së Kursimeve ngarkohet drejtoria e financës dhe e kontabilitetit për përgatitjen e udhëzimeve përkatëse brenda datës 25.6.1994

7. Degët e Bankës së Kursimeve njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Kursimeve për çdo problem që lind gjatë zbatimit, me qëllim që të merren masat përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi